



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 SPORTIT DHE RINISË
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2019
ME ZGJEDHJE

Lënda: Filozofi-Sociologji

Modeli Testi

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **60 pikë**.

Testi ka **20 pyetje** me zgjedhje (alternativa) dhe pyetje të tjera janë me zhvillim.

Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përfori përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përfori saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa									
Pikët									
Kërkesa									
Pikët									
Kërkesa									
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

Sociologji

1. Cili nga pohimet e mëposhtme përshkruan më mirë marrëdhënien ndërmjet normave dhe vlerave? **1 pikë**

- A) Vlerat i bëjnë normat më praktike;
- B) Vlerat ndikojnë në përmbajtjen e normave;
- C) Vlerat rrjedhin prej normave shoqërore;
- D) Vlerat janë more, ndërsa normat janë folkuej.

2. Nën-kultura emërtohet kështu sepse është: **1 pikë**

- A) inferiore ndaj kulturës së shumicës së popullsisë;
- B) superiore në raport me kulturën e shoqërisë sunduese;
- C) modeli i vërtetë kulturor i një shoqërie tradicionale;
- D) model kulturor i dallueshëm në disa aspekte nga kultura sunduese.

3. Argumentoni rëndësinë e vlerës kulturore të mikpritjes në jetën e shoqërisë tradicionale shqiptare nëpërmjet dy funksioneve të mikut në shoqëri. **2 pikë**

4. Shpjegoni tri aspektet kryesore të analizës së zhvillimit të kuptimit për veten të sociologut Xhorxh H. Mid. **3 pikë**

- ---

- ---

- ---

5. Cila nga alternativat e mëposhtme mund të etiketohet si deviante në shoqëritë moderne? **1 pikë**

- A) Një lypsar i varfër;
- B) Një nëpunës i lartë;
- C) Një njeri i pasur;
- D) Një njeri i pushtetshëm.

6. Përcaktimi ose jo si deviant i një modeli sjelljeje, ndikohet nga disa faktorë. Jepni nga një shembull lidhur me faktorët e mëposhtëm: 2 pikë
- a) vlerësimi i sjelljes në raport me norma kulturore të caktuara.
- _____
- _____
- b) vlerësimi i sjelljes në raport me rrethanat shoqërore.
- _____
- _____
7. Identifikoni tri tipare të familjes bërthamë të mbyllur. 3 pikë
- _____
 - _____
 - _____
8. Në qytetin ku banonte një grup minoritar, banorët vendas historikisht kishin ndërtuar marrëdhënie shumë të mira me ta. Minoritarët ishin fqinjë me shtetin "amë" dhe kishin lidhje të ngushta me të. Në sociologji ky grup quhet: 1 pikë
- A) asimilim;
 B) etnicitet;
 C) pakicë etnike;
 D) pakicë kombëtare.
9. Dalloni dy aspekte të asimilimit si formë e marrëdhënieve ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne. 2 pikë
- _____
 - _____
10. Shqipëria dallohet për bashkëjetesën paqësore mes individëve me përkatësi fetare të ndryshme. Cili nga funksionet e mëposhtëm të fesë ka ndikuar më shumë në diversitetin fetar në Shqipëri? 1 pikë
- A) Forcimi i unitetit shoqëror;
 B) Krijimi shoqëror i së shenjtës;
 C) Kontrolli shoqëror;
 D) Përcaktimi i kuptimit të jetës.

11. Andi nuk praktikon ritet fetare, por mërret më shumë me zhvillimin e karrierës së tij.
Në analizat sociologjike të besimeve fetare ky fenomen quhet:

1 pikë

- A) eklesi;
- B) kult;
- C) dinominejshën;
- D) shekullarizim.

12. Shpjegoni, nëpërmjet një shembulli, rolin e fesë si:

2 pikë

- faktor uniteti shoqëror.

- burim mosmarrëveshesh.

13. Qytetet mesjetare në Evropë kishin:

1 pikë

- A) organizim pa hierarki shoqërore;
- B) hierarki shoqërore të ngurtësuar;
- C) lidhje familjare dhe fisnore të paqëndrueshme;
- D) rrjedhë të shpejtë të mënyrës së jetesës.

14. Sociologu Ferdinand Tënis analizoi në mënyrë krahasuese tipin e organizimit shoqëror në zonat fshatare dhe në qytetet industriale të zhvilluara.

Shkruani dy nga dallimet që evidentoi ai ndërmjet mënyrës urbane dhe rurale të jetesës.

2 pikë

Jeta urbane	Jeta rurale
1.	1.
2.	2.

15. Tërësia e ndryshimeve në organizimin e shoqërisë, në modelet e të menduarit dhe të sjelljes së njerëzve në rrjedhën e kohës, quhet:

1 pikë

- A) ndryshim shoqëror;
- B) lëvizje shoqërore strukturore;
- C) lëvizshmëri shoqërore individuale;
- D) shtresëzim shoqëror.

16. Identifikoni dy tipare të shtresimit shoqëror.

2 pikë

- _____

- _____

17. Në cilën shoqëri njerëzit jetojnë duke zgjeruar mundësitë për zgjedhje vetjake dhe duke përvetësuar botëkuptimin racional shkencor?

1 pikë

- A) Në shoqërinë pasmoderne;
- B) Në shoqërinë moderne;
- C) Në shoqërinë tradicionale;
- D) Në shoqërinë patriarkale.

18. Cila nga alternativat e mëposhtme është një karakteristikë e shoqërisë pasmoderne?

1 pikë

- A) Orientimi drejt së ardhmes;
- B) Vetëdijësimi për vlerën e kohës;
- C) Venitja e bashkësive tradicionale;
- D) Ribërja e institucioneve të shoqërisë.

19. Intervista e lirë është një nga metodat e kërkimit në sociologji. Jepni dy tipare të saj.

2 pikë

Filozofi

- 20.** Filozofia e Leukipit dhe Demokritit: **1 pikë**
- A) ka atomet në themel të gjithçkaje;
 B) vendos ujin si substancë themelore;
 C) analizon monadat në rolin e lëvizësit të trupave;
 D) lidhet me apejronin si substancë e papërcaktuar.
- 21.** Nëpërmjet Mitit të Shpellës, Platoni: **1 pikë**
- A) shpreh idealizmin në lidhje me njohjen shqisore;
 B) mohon raportin ndërmjet botës së ideve dhe kopjes së tyre;
 C) shpalos idene se njohja absolute nuk mund të realizohet;
 D) dëshmon kontradiktën e përjetshme ndërmjet dijes dhe padijes.
- 22.** Sofistët realizuan: **1 pikë**
- A) humanizimin e kulturës;
 B) kundërshtimin e retorikës;
 C) pajtimin e teologjisë me filozofinë;
 D) njëtrajtësinë e vlerave shoqërore.
- 23.** **2 pikë**
- a) Si shpjegohet realiteti në filozofinë e Heraklitit nëpërmjet shprehjes:
 “Nuk mund të lahesh dy herë në ujërat e të njëjtit lumë”?
- _____
- _____
- _____
- b) Cila është arsyeja e këtij realiteti sipas tij?
- _____
- _____
- _____
- 24.** **2 pikë**
- a) Cili është themeli i njohjes në logjikën e Epikurit?
- _____
- _____
- _____
- b) Si e shpjegon Epikuri përfytyrimin e sendit edhe në mungesë të tij?
- _____
- _____
- _____
- 25.** Në logjikën e tyre, stoikët u morën me: **1 pikë**
- A) nënvlerësimin e ndijimit;
 B) varësinë e përfytyrimeve nga subjekti;
 C) ndarjen e idesë së përgjithshme nga shqisat;
 D) problemet e njohjes përmes perceptimit shqisor.

- 26.** Bazuar në analizën kritike që skeptikët i bëjnë njohjes shqisore, ata: **1 pikë**
- A) mohojnë ekzistencën e fenomeneve dhe besojnë në njohjen e shkakut të tyre;
 B) pranojnë ekzistencën e fenomeneve por dyshojnë në njohjen e shkakut të tyre;
 C) pranojnë mundësinë e njohjes përtej fenomeneve, që është e arritshme nga përvoja;
 D) analizojnë ekzistencën e fenomeneve dhe shpresojnë të gjejnë shkaqet e tyre.
- 27.** Filozofia në mesjetë ishte: **1 pikë**
- A) në kërkim të një gjuhe sa më të ngjashme me atë të kishës;
 B) e panevojshme si mjet logjik sepse përzihej dija profane me dijet e tjera;
 C) e barazvlefshme me dijet e kishës, por nuk trajtonte jetën dhe njeriun;
 D) e domosdoshme si mjet logjik, por liria e saj ishte e rrezikshme pasi çonte në herezi.
- 28.** Krahasoni thelbin e qytetit të Zotit me thelbin e qytetit tokësor në filozofinë e Shën Agustinit. Jepni dallimet mes tyre në tri aspekte kryesore. **3 pikë**
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- 29.** Forca e pushtetit për Hobsin qëndron tek: **1 pikë**
- A) nënshtrimi i sovranit ndaj kontratës;
 B) pakti reciprok mes pushtetit dhe individëve;
 C) idetë e revolucionit të Kromuellit;
 D) bindja e subjekteve ndaj pushtetit.
- 30.** Identifikoni thelbin e idhujve të mëposhtëm të analizuar nga Frensis Bekon. **3 pikë**
- a) Idhujt e racës
- _____
- _____
- b) Idhujt e shpellës
- _____
- _____
- c) Idhujt e teatrit
- _____
- _____
- 31.** Sipas Volterit, njeriu: **1 pikë**
- A) ka instikte, por arsyeja përmirëson disa prej tyre;
 B) me instiktet që ka, nuk mund ta bëjë arsyen të veprojë;
 C) është i sunduar prej instikteve të lindura bashkë me të;
 D) nuk është i lirë të mposhtë instiktet brenda vetes.

32. Zhan Zhak Ruso mendonte se vet shoqëria bën që njeriu të: 1 pikë

- A) barazojë tjetrin me veten;
- B) ruajë lirinë e tij natyrore;
- C) humbasë lirinë e tij natyrore;
- D) nënshtrojë tjetrin ndaj interesave të veta.

33. Monteskjë vlerësonte hartimin e ligjeve të mira dhe që funksionojnë në shoqëri.
Paraqitni dy faktorë që ai theksonte se duhet të mbahen parasysh në hartimin e tyre. 2 pikë

34. Pikëpamjet etike të Bentamit ndikohen nga: 1 pikë

- A) raporti midis kënaqësisë dhe dhimbjes;
- B) gjykimet morale dhe etike si të pavërteta;
- C) trajtimi i moralit si tërësi gjykimesh përfundimtare;
- D) vlerësimi për ngjarjet morale si të dhëna faktike të ngurta.

35. 3 pikë

a) Identifikoni se nga cila tezë rrjedh mendimi i Hegelit se realiteti është racional.

b) Shpjegoni dy aspekte themelore të kësaj teze.

36. Identifikoni dy veçori të stadiit estetik në jetën e njeriut sipas Kirkegardit. 2 pikë

- ---
- ---

37. Analizoni tri aspekte kryesore të ekzistencializmit ateist të Sartrit bazuar në thënien
"Ekzistenca vjen para thelbit njerëzor." 3 pikë
